f) Krijon një inventar të emetimeve, shkarkimeve dhe humbjeve, ku përfshihen, nëse janë të disponueshme, hartat e emetimeve, shkarkimeve dhe humbjeve të të gjitha substancave prioritare dhe ndotësve, të përcaktuar sipas ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar, për çdo rajon të basenit lumor dhe për ato pjesë të rajonit ndërkufitar të basenit lumor, që bie brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë edhe përqendrimet e tyre në sedimente dhe biotë;

g) Harton normativa, standarde, kërkesa, kritere dhe praktika të unifikuara për ruajtjen, përdorimin, rehabilitimin dhe përmirësimin e burimeve ujore, duke bashkëpunuar, sipas ligjit, me çdo ministri apo institucion përgjegjës;

gj) Përcakton, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për ujësjellës-kanalizimet, kërkesat dhe standardet për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar;

h) Mban të dhënat/databazat tematike të sektorit dhe orienton e mbështet kërkimet, studimet, publikimet me karakter shkencor e teknik sipas ligjit;

i) Është përgjegjëse për marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe garanton angazhimin e aktorëve, duke ngritur sistemin e ndërveprimit (mban databaza, dokumente, manuale, plane, teknika, raporte mbi komunikim-ndërveprimin e aktorëve, ndjek ngritjen e komisioneve, komiteteve apo grupeve të punës për çështje që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore) në mënyrë të integruar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme;

j) Kryen analiza, modelime dhe simulime / skenarë mbi burimet ujore dhe sjelljen e tyre, në nivel baseni apo trupi ujor, bazuar në modele matematikore të integruara në aplikacione dhe programe kompjuterike;

k) Nxit inovacionin, digjitalizimin dhe aplikimin e modeleve/praktikave më të mira në lidhje me vlerësimin, mbrojtjen dhe përdorimin e burimeve ujore;

l) Siguron bashkërendimin e dispozitave të ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar, në lidhje me përmbushjen e objektivave mjedisorë dhe veçanërisht të programeve të masave me autoritetet e tjera;

ll) Koordinon proceset e punës për hartimin dhe rishikimin e komponentëve të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit Detar, duke bashkëpunuar me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, turizmin, akuakulturën dhe organet përgjegjëse për zonat e mbrojtura detare dhe monitorimin e ujërave detare;

m) Drejton e bashkërendon punën me ministritë e linjës për të gjitha proceset integruese në Bashkimin Evropian, për sa i përket sektorit të ujit.

3. Agjencia ka këto përgjegjësi dhe detyra për menaxhimin e sektorit të ujit:

a) Planifikon, ekzekuton, kontrollon punën dhe garanton që produktet apo shërbimet janë të duhurat, në kohën e duhur, brenda buxhetit e në sasinë dhe në cilësinë e kërkuar:

i. duke integruar kërkesat për realizimin e një produkti optimal, të qëndrueshëm e të sigurt, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;

ii. duke analizuar progresin, vlerësuar devijimet nga objektivat, standardet dhe planin e menaxhimit, si dhe duke menaxhuar ndryshimet e nevojshme në program dhe në burime.

b) Harton e ndjek zbatimin e të gjitha planeve të menaxhimit të kërkuara nga ligji, në bashkëpunim me zyrat e administrimit të baseneve lumore, strukturat shtetërore përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe në bashkëpunim me aktorët e tjerë;

c) Kryen analizën e karakteristikave dhe vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor për çdo trup ujor në basen, për të përcaktuar statusin e trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, si dhe përditësimet e tyre për çdo rajon të basenit lumor apo pjesë të një baseni lumor ose liqenor ndërkombëtar, që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ç) Harton programin e monitorimit të statusit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për çdo rajon të basenit lumor, me qëllim vlerësimin e statusit të trupave ujorë;

d) Kryen analizën e tendencës afatgjatë të përqendrimeve të substancave prioritare, të përcaktuara si të tilla, në përputhje me ligjin nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar, që kanë prirjen të grumbullohen në sedimente ose biotë, duke u bazuar në rezultatet e monitorimit të statusit të ujërave sipërfaqësore;

dh) Identifikon burimet ujore të ndikuara apo që mund të ndikohen nga ndotja e shkaktuar nga nitratet me origjinë bujqësore;

e) Identifikon e propozon elementet e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik të lumenjve, liqeneve, ujërave transitore, ujërave bregdetare dhe trupave ujorë sipërfaqësorë artificialë dhe tepër të modifikuar;

ë) Identifikon rastet kur ndotjet e përqendruara mund të rrezikojnë arritjen e objektivave të cilësisë mjedisore;

f) Menaxhon dhe koordinon procesin e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të nismave/projekteve/programeve për administrimin e burimeve ujore në bashkëpunim me ministritë e linjës, institucionet qendrore e vendore, donatorë dhe partnerë të tjerë zhvillimorë;

g) Siguron koordinimin e përgjithshëm të organeve të administrimit të burimeve ujore, njësive të vetëqeverisjes vendore, organeve dhe strukturave përgjegjëse të ministrive, institucioneve shtetërore e aktorëve përkatës për marrjen e masave dhe zbatimin e legjislacionit në sektorin e ujit;

gj) Koordinon veprimtaritë e hartimit të planeve të menaxhimit të riskut nga përmbytjet me autoritetet e tjera, me fokus përmirësimin e efikasitetit, shkëmbimin e informacionit, përgatitjen e hartave, analizimin e skenarëve dhe sigurimin e sinergjive dhe përfitimeve të përbashkëta, duke synuar arritjen e objektivave mjedisorë;

h) Kryen vlerësimin e statusit të ujërave detarë dhe harton programin e monitorimit, duke përdorur metodologji, të cilat janë në harmoni me ato shteteve të tjera, me të cilat Shqipëria ndan sovranitetin mbi këto ujëra, për të mundësuar koherencën e krahasueshmërinë e rezultateve.

4. Agjencia ka këto përgjegjësi dhe detyra operacionale në sektorin e ujit:

a) Planifikon, zbaton, ndjek, garanton optimizimin e përdorimit të burimeve njerëzore, materialeve, aseteve të nevojshme për kryerjen e proceseve të punës për menaxhimin e burimeve ujore;

b) Realizon të gjitha proceset e punës, pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, si dhe bashkërendon e kontrollon punën e zyrave të administrimit të baseneve lumore;

c) Ndjek zbatimin e programeve të masave të përcaktuara në planet e menaxhimit të baseneve lumore për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore;

ç) Ndjek zbatimin e proceseve të punës lidhur me burimet ujore nga ministritë përkatëse dhe

bashkëpunon me to, sipas detyrimeve e kërkesave specifike të kuadrit ligjor;

d) Kryen të gjitha veprimet përgatitore në lidhje me materialet që do të paraqiten për shqyrtim në mbledhjet e KKTU-së, brenda fushës së përgjegjësisë që ka ky organ lidhur me menaxhimin e burimeve ujore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar, duke koordinuar marrëdhëniet me sekretariatin teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

dh) Pranon kërkesat dhe shqyrton dokumentacionin tekniko-ligjor të paraqitur nga subjektet fizike dhe juridike, që kërkojnë miratim në parim, për nisjen e një procedure koncesioni, për leje apo autorizim për përdorim burimi ujor, si dhe bën propozimet përkatëse në Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Ujit ose në Këshillin e Basenit Lumor, sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e veprimtarisë përkatëse;

e) Miraton kërkesat për autorizime apo leje për veprimtari të caktuara, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar;

ë) Ndjek dhe monitoron zbatimin e kushteve e të kritereve të përcaktuara në lejet/autorizimet e dhëna për përdorimin e ujit, si dhe ndërmerr masat ndaj subjekteve që gjenden në shkelje;

f) I propozon KKTU-së dhe/ose KBL-së rishikimin, rinovimin, ndryshimin, transferimin, pezullimin, revokimin e lejeve apo të autorizimeve;

g) Siguron mbledhjen e të ardhurave nga tarifat e përdorimit të ujit dhe pagesat për shpenzimet administrative, nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve lumore apo marrëveshjeve me të tretë dhe i derdh në buxhetin e shtetit;

gj) Merr pjesë, nëpërmjet dhënies së mendimit, në çdo procedurë për vlerësimin e ndikimit mjedisor apo vlerësimin strategjik mjedisor, kur veprimtaria dhe instalimi i propozuar kanë ndikim në burime ujore;

h) Merr pjesë në procedurat e dhënies së lejeve mjedisore, të cilat kanë ndikim në burime ujore, duke përcaktuar kërkesat e veta, me qëllim arritjen e objektivave të cilësisë mjedisore, të përcaktuar në përputhje me ligjin nr. 29/2024, "Për burimet ujore", të ndryshuar, lidhur me kontrollin e ndotjes së ujërave;

i) Mbledh, strukturon, përpunon, administron dhe publikon të dhëna sasiore e cilësore mbi burimet ujore dhe i vë ato në dispozicion të institucioneve, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës;

j) Promovon rëndësinë e burimeve ujore, nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të burimeve ujore dhe komunitetit në përdorimin e qëndrueshëm të ujit, përmes fushatave ndërgjegjësuese, botimeve, publikimeve, konferencave, seminareve, forumeve apo konsultimeve.

5. Zyra e Administrimit të Basenit Lumor (ZABL), mbështetur në detyrat e përcaktuara në ligj, ka këto detyra administrative dhe kompetenca territoriale:

a) Në lidhje me Këshillin e Basenit Lumor (KBL):

i. ushtron funksionet e sekretariatit teknik dhe organizon mbledhjen e KBL-së;

ii. i propozon KBL-së rishikimin, ndryshimin, pezullimin, revokimin e lejeve apo të autorizimeve;

iii. përfaqëson Këshillin e Basenit Lumor në çështjet gjyqësore.

b) Ndjek zbatimin e vendimeve të AMBU-së, KKTU-së dhe KBL-së, si dhe përmbushjen e detyrimeve financiare të përdoruesve të burimeve ujore brenda basenit përkatës, pavarësisht nga organi që ka miratuar veprimtarinë;

c) Merr iniciativa për ndërgjegjësimin e përdoruesve të ujit lidhur me procesin e formalizimit;

ç) Mbledh të dhëna dhe informacione në nivel baseni në kuadër të hartimit të planeve të menaxhimit të baseneve lumore;

d) Harton inventarin sasior e cilësor të burimeve ujore në nivel baseni, duke i përditësuar periodikisht;

dh) Përgatit raporte dhe jep opinione për burimet ujore në nivel baseni, bazuar në rezultatet e monitorimeve të kryera ndaj përdoruesve të burimeve ujore;

e) Hedh të dhënat në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve lidhur me lejet/autorizimet e përdorimit të burimeve ujore të lëshuara nga KBL-ja përkatëse.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në momentin e fillimit të funksionimit të plotë të Agjencisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, Agjencia vijon funksionimin sipas strukturave dhe organikave aktuale të miratuara.

2. Vendimi nr. 221, datë 26.4.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e

Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", i ndryshuar", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zyrat e administrimit të baseneve lumore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 336, datë 19.6.2025**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TË DHËNAVE DHE SHËRBIMEVE TË AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR QË DO TË TARIFOHEN, SI DHE TË MASËS SË TARIFËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së të dhënave dhe shërbimeve që do të tarifohen nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, në zbatim të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të tarifave përkatëse për çdo të dhënë e shërbim, si dhe të mënyrës së aplikimit të tyre.

2. Lista e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, si dhe tarifat përkatëse janë sipas anekseve I dhe II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Të ardhurat e realizuara nga tarifat derdhen 100% në buxhetin e shtetit, në përputhje me vendimin nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijohen nga institucionet buxhetore".

4. Tarifat për të dhënat dhe shërbimet gjeohapësinore bëhen publike në faqen zyrtare të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeo-hapësinor.

5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

ANEKSI I

1. Të dhëna dhe shërbime nga Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare:

- Monografitë e pikave të rrjetit pasiv GNSS (rendi I, II);
- Monografitë e pikave të rrjetit gravimetrik (rendi 0, I, II, III);
- Monografitë e pikave të rrjetit të nivelimit (rendi I, II);
- Monografitë e pikave të rrjetit magnetometrik (rendi 0, I, II, III).

Të dhënat dhe shërbimet nga Korniza Referuese Gjeodezike do të ofrohen të printuara dhe të vulosura në formatin A4 (.pdf), fizikisht dhe në formë elektronike për të gjithë përdoruesit.

Lista e produkteve së bashku me çmimeve përkatëse për monografitë e pikave të rrjeteve përbërëse të Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare:

| **Monografitë e pikave gjeodezike të rrjeteve të KRGJSH-së** | | | |
|---|---|---|---|
| **Përshkrimi** | **Numri i pikave** | **Rendi** | **Çmimi /1 (një) pikë** |
| Pikat e rrjetit pasiv GNSS | 42 | I | 700 lekë |
| Pikat e rrjetit gravimetrik absolut (R0) | 3 | 0 | 700 lekë |
| Pikat e rrjetit gravimetrik (RI) | 42 | I | 700 lekë |
| Pikat e rrjetit gravimetrik (RII) | 338 | II | 700 lekë |
| Pikat e rrjetit gravimetrik (RIII) | 772 | III | 700 lekë |
| Pikat e rrjetit të nivelimit (RI) | 51 | I | 700 lekë |
| Pikat e rrjetit të nivelimit (RII) | 338 | II | 700 lekë |
| Pikat e mikrorrjetit të stacioneve mareografik | 10 | I | 700 lekë |
| Pikat e rrjetit magnetometrik | 11 | I | 700 lekë |

| | |
|---|---|
| Të shoqëruara me përshkrim shtesë | 500lekë |

2. Shërbimet e sistemeve CORS:
- Shërbimi RTK, pozicionim i precizonit të lartë;
- Shërbimi DGPS pozicionim diferencial;
- Shërbimi i RINEX Data për përpunimin e matjeve me *post-processing.*

Lista e çmimeve për shërbimet e sistemeve CORS:

| **Rrjeti shtetëror aktiv - ALBCORS** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Shërbimi** | **Kohëzgjatja** | **Çmimi (lekë)** |
| 1 | Regjistrimi fillestar i një përdoruesi* | 1 herë | 2,000 |
| 2 | RTK | 1 muaj | 8,000 |
| 3 | RTK | 3 muaj | 22,000 |
| 4 | RTK | 6 muaj | 35,000 |
| 5 | RTK | 1 vit | 60,000 |
| 6 | DGPS | 1 vit | 35,000 |
| 7 | RINEX 1 sek (për stacion) | 1 orë | 1,000 |
| 8 | RINEX 1 sek (për stacion) | 24 orë | 8,000 |
| 9 | RINEX 1 sek (për stacion) | 1 muaj | 20,000 |
| 10 | RINEX 1 sek (për stacion) | 1 vit | 100,000 |

* Regjistrim fillestar i një përdoruesi quhet çdo regjistrim që realizohet për çdo numër serial që identifikohet pajisja.

3. Të dhëna fotogrametrike dhe hartografike:
- Hartë bazë në format pdf;
- Hartë bazë (vektor) në formatet që suportojnë programet GIS;

Lista e çmimeve për shërbimet e ofruara:

| **Harta bazë 1:2000** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Shërbimi** | **Madhësia** | **Çmimi (lekë)** |
| 1 | Harta bazë në format .pdf | A4 1:2000 (~ 20 ha) | 3,000 |
| 2 | Harta bazë në format .pdf | A3 1:2000 (~ 42 ha) | 8,000 |
| 3 | Harta bazë (vektor) në format GIS | 1 ha | 2,900 |

Të dhënat dhe shërbimet e parashikuara në këtë aneks ofrohen për individë dhe subjekte private, në funksion të realizimit të detyrave të tyre për punimet e ndryshme gjeodezike, inxhinierike dhe shkencore.

ANEKSI II

1. Të dhëna dhe shërbime *Remote Sensing*

| **Nr. shërbimit** | **Kategoria** | **Shërbimi** | **Çmimi (ALL) materiale arkivi** | **Çmimi (ALL) materiale të dedikuara** | **Minimumi** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Indekset e vegjetacionit (Raster + Vektor) | NDVI | 770 lekë/km$^2$ | 800 lekë /km$^2$ | Sipërfaqja minimale 10 km$^2$ |
| 2 | | EVI | 770 lekë/km$^2$ | 800 lekë /km$^2$ | |
| 3 | | SAVI | 770 lekë/km$^2$ | 800 lekë /km$^2$ | |
| 4 | | LAI | 770 lekë/km$^2$ | 800 lekë /km$^2$ | |
| 5 | Indekset e ujit (Raster + Vektor) | NDWI | 770 lekë/km$^2$ | 800 lekë /km$^2$ | |
| 6 | | Indeksi i klorofilit | 770 lekë/km$^2$ | 800 lekë /km$^2$ | |
| 7 | | Indeksi i turbulencës | 770 lekë/km$^2$ | 800 lekë /km$^2$ | |
| 8 | | Indeksi i sedimentit | 770 lekë/km$^2$ | 800 lekë /km$^2$ | |
| 9 | Mbulesa e tokës (Raster + Vektor) | Mbulesa e tokës për rezolucion lm | 1 200 lekë/km$^2$ | 1 300 lekë /km$^2$ | |
| 10 | Dedektim objektesh (vektor) | Identifikimi i serrave bujqësore | 1 200 lekë/km$^2$ | 1 300 lekë /km$^2$ | |
| 11 | | Identifikimi i ndërtesave | 1 200 lekë/km$^2$ | 1 300 lekë /km$^2$ | |
| 12 | Produkte të përftuara nga droni | Ortofoto droni | 1 000 lekë/ha | 1 200 lekë /ha | Sipërfaqja minimale 100 ha |
| 13 | | Gjenerim DSM | 1 000 lekë/ha | 1 200 lekë /ha | |
| 14 | | Gjenerim DTM | 1 000 lekë/ha | 1 200 lekë /ha | |
| 15 | | Gjenerimi i izoipseve | 1 000 lekë/ha | 1 200 lekë /ha | |
| 16 | Produkte të përftuara nga fotografimi 360° | Imazhe 360° | 700 lekë /km | 2 500 lekë /km | Distanca minimale 10 km |

**VENDIM**
**Nr. 337, datë 19.6.2025**

## PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar; të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Lidhja nr. 1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Në pikën 5, të lidhjes nr. 3, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i. shkronja "a" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) në masën 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet "Sekretar i përgjithshëm" dhe "Zëvendëssekretar i përgjithshëm".";

ii. nënndarja "v", e shkronjës "g", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"v. "koordinator" në njësinë e menaxhimit pranë sekretarit të përgjithshëm dhe në njësinë e menaxhimit pranë zëvendëssekretarit të përgjithshëm.";

c) Lidhja nr. 7 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2025, përballohen nga buxheti i miratuar për Kryeministrinë për këtë vit dhe fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve/punonjësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 1**

## Kategoritë e klasat e pozicioneve të punës, si dhe vlerat mujore të shtesave të pozicioneve të nëpunësve civilë dhe nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në pikën 2, të kreut II

| Kategoria | | Klasa e pagës (pozicioneve të punës për secilën kategori) | Elementet e pagës bruto mujore, përjashtuar shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) dhe për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, që jepen rast pas rasti sipas përcaktimit në këtë vendim | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga për pozicion (lekë në muaj) | Shtesa e nivelit të kualifikimit | Shtesa për vjetërsi (sipas mënyrës së llogaritjes së përcaktuar në shkronjën "ç", të pikës 1, të kreut II) |
| *1* | | *2* | *3* | *4* | *5* |
| E lartë drejtuese | I | I-1 | 235 000 | 1 | |
| | | I-1/1 | 226 000 | 1 | |
| | | I-2 | 217 000 | 1 | |
| | | I-3 | 205 000 | 1 | |
| | | I-4 | 180 000 | 1 | |
| | | I-5 | 170 000 | 1 | |
| E mesme drejtuese | II | II-1 | 155 000 | 1 | |
| | | II-2 | 141 000 | 1 | |
| E ulët drejtuese | III | III-1 | 115 000 | 1 | |
| | | III-2 | 105 000 | 1 | |
| | | III-3 | 98 000 | 1 | |
| Ekzekutive | IV | IV-1 | 90 000 | 1 ose 2 | |
| | | IV-2 | 80 000 | 1 ose 2, ose 3 | |
| | | IV-3 | 70 000 | 1 ose 2, ose 3 | |
| | | IV-4 | 60 000 | 1 ose 2, ose 3 | |

**Lidhja nr. 7**

## Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve civilë/nëpunësve në institucionet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi

| Pozicioni | Klasa e pagës | Grupi i diplomës |
|---|---|---|
| Sekretar i përgjithshëm në:<br>Kryeministri, Presidencë, Kuvend, Prokurori të Përgjithshme, Avokatin e Popullit. | I-1 | 1 |
| Zëvendëssekretar i përgjithshëm në Kryeministri. | I-1/1 | 1 |
| Sekretar i përgjithshëm në ministri dhe institucionet e tjera të pavarura.<br>Drejtor ekzekutiv i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.<br>Drejtor departamenti në Kryeministri. | I-2 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përgjithshme të përmbajtjes (përgjegjëse për çështjet e zhvillimit dhe politikave të sektorit që mbulon institucioni, si dhe për çështjet rregullatore).<br>Ndihmëskomisioner kategoria e parë në institucionin e Avokatit të Popullit.<br>Zëvendësdrejtor ekzekutiv i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.<br>Kancelar i Gjykatës së Lartë. | I-4 | 1 |
| Drejtor i drejtorive të përgjithshme mbështetëse. | I-5 | 1 |
| Drejtor ekzekutiv i Qendrës për Teknologjinë e Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.<br>Drejtor i drejtorive të përmbajtjes (përgjegjëse për çështjet e zhvillimit dhe politikave të sektorit që mbulon institucioni, si dhe për çështjet rregullatore).<br>Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar.<br>Ndihmëskomisioner kategoria e dytë në institucionin e Avokatit të Popullit. | II-1 | 1 |
| Drejtor i drejtorive mbështetëse. | II-2 | 1 |
| Ndihmësit ligjorë pranë prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ekspertët në Prokurorinë e Përgjithshme. | III-1 | 1 |
| Përgjegjës sektori. | III-1 | 1 |
| Kryesekretar gjyqësor. | III-2 | 1 |
| Specialist.<br>Sekretar gjyqësor. | IV-1 | 1 ose 2 |
| Specialist. | IV-2 | 1 ose 2, ose 3 |
| | IV-3 | 1 ose 2, ose 3 |
| Këshilltar ligjor jomagjistratë në Gjykatën e Lartë. | Paga bruto fillestare e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, pa përfitimet e tjera financiare, sipas referimeve të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. | Sipas përcaktimeve të ligjit përkatës për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. |

**VENDIM**
**Nr. 338, datë 19.6.2025**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 575, DATË 24.6.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 37, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 575, datë 24.6.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në fjalinë e dytë të pikës 4, fjalët "... të vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", të ndryshuar." zëvendësohen me "... të vendimit nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e katalogut të mbetjeve.".

2. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

"8/1. Në përputhje me qëllimin e këtij vendimi, mbetjet inerte të krijuara nga projekti i ndërtimit, i riparimit, i restaurimit apo i prishjes së objektit ripërdoren për ndërtim, nëse janë të përshtatshme për këtë funksion. Nëse mbetjet inerte të krijuara në sheshin e projektit ripërdoren në shesh ndërtimi tjetër apo nëse ruhen përkohësisht në një vend tjetër deri në ripërdorimin e tyre, subjekti zhvillues apo përfituesi i lejes së ndërtimit paraqet dokumentacionin e mëposhtëm, sipas rastit:

a) Kur inertet ripërdoren për qëllime ndërtimi nga vetë subjekti zhvillues apo përfituesi i lejes së ndërtimit, por në një vend tjetër, ai paraqet deklaratën personale për qëllimin e përdorimit së bashku me dokumentacionin ose të dhënat për sheshin tjetër të ndërtimit, ku do të përdoren inertet (lejen përkatëse të ndërtimit); ose

b) Kur inertet ripërdoren për qëllim ndërtimi nga të tretë në një vend tjetër, subjekti zhvillues apo përfituesi i lejes së ndërtimit paraqet marrëveshjen (kontratën) e lidhur me ta për këtë qëllim, së bashku me dokumentacionin ose të dhënat për sheshin tjetër të ndërtimit, ku do të përdoren inertet (lejen përkatëse të ndërtimit); ose

c) Kur inertet ruhen përkohësisht në një vend tjetër përpara ripërdorimit të tyre për qëllime ndërtimi, subjekti zhvillues apo përfituesi i lejes së ndërtimit paraqet:

i. marrëveshjen me operatorin për depozitimin e inerteve përkohësisht në një venddepozitim të përkohshëm, deri në ripërdorimin për qëllime ndërtimi. Nëse ato do të ripërdoren nga të tretë, paraqitet edhe kontrata e lidhur me ta për këtë qëllim; ose

ii. deklaratën për depozitimin përkohësisht, deri në ripërdorimin për qëllime ndërtimi, në një pasuri të paluajtshme në pronësi të tij, ose marrëveshjen me pronarin, kur pasuria nuk është në pronësi të tij, të shoqëruara me kopje të kartelës së pasurisë. Në çdo rast, pasuria të përmbushë kriteret e përcaktuara në pikën 17 të këtij vendimi, dhe depozitimi sipas kësaj nënndarjeje nuk mund të zgjasë më shumë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë. Nëse mbetjet inerte ripërdoren nga të tretë, paraqitet edhe kontrata e lidhur me ta për këtë qëllim.".

3. Pas pikës 20 shtohet pika 20/1, me këtë përmbajtje:

"20/1. Krahas subjekteve private, roli i operatorit, në kuptim të këtij vendimi, ushtrohet edhe nga Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (në vijim "AKEM").

Për venddepozitimet e përkohshme të administruara nga operatorë që janë subjekte private, AKEM-i ushtron mbikëqyrjen dhe ndjekjen e funksionimit të venddepozitimit për qëllime të përputhshmërisë me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Rregullat e hollësishme të mbikëqyrjes dhe ndjekjes së funksionimit të venddepozitimeve përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin. Në rast të konstatimit të shkeljeve të standardeve dhe të kritereve të venddepozitimit nga operatori, zbatohen masat administrative të parashikuara në legjislacionin e posaçëm të mbrojtjes së mjedisit.

4. Pas pikës 21 shtohen pikat 21/1, 21/2, 21/3, 21/4, 21/5 dhe 21/6, me këtë përmbajtje:

"21/1. AKEM-i i kërkon njësisë së vetëqeverisjes vendore informacionin për vendet e përcaktuara prej saj për t'u përdorur si venddepozitime të përkohshme dhe specifikisht mbi ato që shtrihen në pasuri shtetërore. Në rast se nuk është e qartë gjendja juridike e pronësisë mbi pasuritë, AKEM-i kërkon informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Pas vlerësimit të këtyre vendeve, AKEM-i njofton njësinë e vetëqeverisjes vendore për ato pasuri shtetërore, të cilat do t'i administrojë si venddepozitime të përkohshme.

21/2. Marrja në administrim nga AKEM-i i pasurive, sipas përcaktimit në pikën 21/1 të këtij vendimi, kryhet në një nga këto mënyra:

a) Nëpërmjet përcaktimit ose ndryshimit të përgjegjësisë së administrimit të pasurisë shtetërore tek AKEM-i, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, në rastin kur ajo është pronë e patransferuar te njësitë e vetëqeverisjes vendore; ose

b) Nëpërmjet marrëveshjes që lidhet ndërmjet AKEM-it dhe organeve të saj (njësisë së vetëqeverisjes vendore), me objekt përdorimin e pasurisë nga AKEM-i për qëllimet e këtij vendimi ose sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, kur prona i është transferuar njësisë së vetëqeverisjes vendore.

21/3. Venddepozitimet e përkohshme miratohen me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.

21/4. AKEM-i dhe operatorët privatë, që respektojnë në çdo rast kriteret e pikës 17 të këtij vendimi, kërkojnë pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore miratimin e tarifës përkatëse, në bazë të pikës 15 të këtij vendimi, pa qenë nevoja për të miratuar ndryshime në planin e përgjithshëm vendor.

Pas miratimit të tarifës, AKEM-i ose operatorët privatë i drejtohen Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për miratimin e lejeve të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

21/5. Operatorët privatë, para marrjes së lejes së ndërtimit për venddepozitim të përkohshëm nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, duhet të depozitojnë një garanci financiare/bankare për të mbuluar kostot e ndërtimit, të operimit, të mbylljes e të kujdesit të mëtejshëm të *landfill*-it pas mbylljes së tij, përfshirë pagesën e garancisë për kostot e mbylljes së tij, ndërhyrjet e mëpasshme dhe rehabilitimin e mjedisit, për llogari të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila nuk do të jetë më pak se 10% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak.

21/6. Në çdo rast, për lejet e lëshuara nga autoritetet e zhvillimit të territorit, subjekti zhvillues apo përfituesi i lejes së ndërtimit ka detyrimin të njoftojë përkatësisht sekretariatin teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për lejet në kompetencë të tij, autoritetin vendor dhe, në të gjitha rastet, AKEM-in, nëse, pas marrjes së lejes së ndërtimit, mbetjet inerte do të ruhen në një venddepozitim tjetër të përkohshëm, të ndryshëm nga ai i përcaktuar gjatë procedurave të lejes së ndërtimit, sipas përcaktimeve të pikës 8 të këtij vendimi.".

5. Në pikën 20, fjalët "... ministria që mbulon infrastrukturën publike ..." zëvendësohen me "... ministria përgjegjëse për mbetjet ...".

6. Në pikën 21, fjalët "... në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën publike ..." hiqen.

7. Pika 25 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"25. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 339, datë 19.6.2025

## PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE NDAJ TË TRETËVE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE USHTARAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 88/2024, "Për krijimin e Shoqërisë Shtetërore për Prodhimin dhe Tregtimin e Armëve, Municioneve, Pajisjeve dhe Teknologjive Ushtarake", dhe të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me

propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj të tretëve, në masën 244 541 460 (dyqind e dyzet e katër milionë e peseëqind e dyzet e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë, të ndërmarrjeve shtetërore Uzina e Lëndëve Plasëse Mjekës Elbasan, Uzina Mekanike Gramsh dhe Kombinati Mekanik Poliçan, nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, detajuar sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2025, për Ministrinë e Mbrojtjes, në programin buxhetor "Mbështetja e luftimit".

3. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përfundon brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Lidhja nr. 1**
**Detyrime të ndërmarrjeve shtetërore ushtarake**

**në lekë**

| NDERMARRJET SHTETERORE USHTARAKE | VLERA |
|---|---|
| UZINA E LENDEVE PLASESE, MJEKES | 64,554,306 |
| UZINA MEKANIKE GRAMSH | 2,055,154 |
| KOMBINATI MEKANIK POLICAN | 177,932,000 |
| TOTALI DETYRIMEVE | 244,541,460 |

**VENDIM**
**Nr. 341, datë 19.6.2025**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, e 25, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*", bëhet delistimi i një individi, renditur në shkronjën "a", sipas shtesës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së

(LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe Al-QAIDA

a) Delistim nga "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida";

1. HAJJAJ BIN FAHAD AL AJMI

*Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.*

**VENDIM**
**Nr. 342, datë 19.6.2025**

**PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS PËR ZBATIMIN E PROTOKOLLIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE, PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MIGRACIONIT DHE TË MARRËVESHJES ZBATUESE TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 20/2024, "Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Task-Forcës për zbatimin e protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit, si dhe të marrëveshjes zbatuese të tij.

2. Task-Forca ka për qëllim koordinimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes, në përputhje me fushën e përgjegjësisë së institucioneve të përfshira.

3. Task-Forca kryesohet nga zëvendësministri i Brendshëm, përgjegjës për çështjet e migracionit, dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- Zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Zëvendësministrin e Mbrojtjes;
- Zëvendësministrin e Financave;
- Zëvendësministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Zëvendësministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Drejtorin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- Drejtorin e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Drejtorin e Departamentit për Rendin dhe Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Drejtorin e Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

4. Task-Forca ka si detyrë:

a) të hartojë planin e veprimit, sipas fushave të përgjegjësive të institucioneve të përfshira, si një dokument i vetëm i miratuar;

b) të evidentojë strukturat, përgjegjësitë dhe detyrimet, në rast të situatave të paparashikuara që lindin gjatë zbatimit të protokollit dhe të marrëveshjes zbatuese të tij;

c) të garantojë mbështetjen e strukturave të angazhuara me burimet e nevojshme për përmbushjen e përgjegjësive të tyre, në zbatim të protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit, si dhe të marrëveshjes zbatuese të tij;

ç) të trajtojë kërkesat dhe çështjet e përcjella nga Ambasada e Republikës së Italisë në Tiranë nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, që lidhen me zbatimin e protokollit dhe të marrëveshjes zbatuese, si dhe merr vendime, të cilat i përcillen për zbatim strukturave përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

5. Task-Forca mblidhet me kërkesë të kryetarit dhe të çdo anëtari të saj, në varësi të çështjes që shtrohet për diskutim, sipas një kalendari takimesh ose sa herë vlerësohet e nevojshme.

6. Task-Forca, kur e vlerëson të nevojshme, fton në mbledhjet e saj ekspertë të jashtëm ose përfaqësues nga organizata, që mbulojnë fushën e institucioneve të përfshira, për çështje që janë jashtë profilit të saj dhe opinioni i tyre bëhet pjesë e vendimmarrjes.

7. Anëtarët e Task-Forcës njoftojnë kryetarin për çdo problematikë dhe vendimmarrje, sipas fushës së përgjegjësisë.

8. Kryetari i Task-Forcës raporton çdo muaj pranë ministrit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

9. Task-Forca mbështetet nga sekretariati teknik, i përbërë nga përfaqësues të nivelit të mesëm drejtues dhe/ose të lartë drejtues, i cili ka në përbërje:

a) përfaqësues të Drejtorisë së Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut në Ministrinë e Brendshme;

b) përfaqësues të strukturës për rendin dhe sigurinë publike në Ministrinë e Brendshme;

c) përfaqësues nga Drejtoria Konsullore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;

ç) përfaqësues nga Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

10. Detyrat e sekretariatit teknik janë:

a) organizimi i mbledhjeve të Task-Forcës, në përputhje me procedurat ligjore të njoftimit për mbledhjet e komisioneve të posaçme;

b) përgatitja e relacionit për çështjet në diskutim, si pjesë e dokumentacionit që do të diskutohet, dhe koordinimi me institucionet e përfshira në këtë Task-Forcë;

c) administrimi i dokumenteve të ardhura nga pala italiane dhe paraqitja e tyre Task-Forcës për shqyrtim dhe koordinim të veprimeve të mëtejshme, sipas udhëzimeve të saj;

ç) mbledhja e të dhënave dhe informacionit të ardhur nga anëtarët;

d) shkëmbimi i informacionit dhe materialeve të mbledhjes midis anëtarëve;

dh) hartimi i materialeve për kryetarin e Task-Forcës;

e) mbajtja dhe administrimi i procesverbalit të mbledhjes.

11. Task-Forca është funksionale deri në përfundimin e zbatimit të protokollit.

12. Ngarkohen titullarët e institucioneve, të përmendura në pikën 3 të këtij vendimi, që brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, të caktojnë dhe të dërgojnë pranë Ministrisë së Brendshme emrat e përfaqësuesve të tyre në këtë Task-Forcë, si dhe në sekretariatin teknik mbështetës, sipas shkronjave "c" e "ç", të pikës 9.

13. Ngarkohet Task-Forca për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 343, datë 19.6.2025

## PËR CAKTIMIN E MINISTRISË SË FINANCAVE SI PËRFAQËSUESE TË SHTETIT SHQIPTAR NË CILËSINË E AKSIONARIT TË PARË TË SHOQËRISË "BANKA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT" SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 23/2025, "Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Ministrisë së Financave si përfaqësuese të shtetit shqiptar në cilësinë e aksionarit të parë të shoqërisë "Banka Shqiptare e Zhvillimit" sh.a.

2. Ministria e Financave përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë "Banka Shqiptare e Zhvillimit" sh.a.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për ndjekjen e procedurave të mëtejshme, në zbatim të ligjit nr. 23/2025, "Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit".

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe shoqëria "Banka Shqiptare e Zhvillimit" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

## VENDIM
## Nr. 345, datë 19.6.2025

## PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PRONAVE SHTETËRORE PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT "RIJETËZIMI I STADIUMIT 'NIKO DOVANA', DURRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare", dhe të shkronjës "b", të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr.

137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare" sh.a., me NIPT: M01917011D, të pronave shtetërore sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për realizimin e projektit të investimit "Rijetëzimi i stadiumit 'Niko Dovana', Durrës".

2. Autorizimin e shoqërisë aksionare "Korporata e Investimeve Shqiptare" sh.a., vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, dhe autorizimit të dhënë nga Këshilli Bashkiak Durrës nëpërmjet vendimit nr. 125, datë 27.7.2023, në funksion të realizimit të projektit të investimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i cili ka si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.

3. Autorizohen Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucioni i përcaktuar në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi apo autoritetet e autorizuara prej tyre, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, përmbushjen e interesit të Korporatës, si dhe entiteteve në pronësi të të cilit/ave regjistrohet prona e re shtetërore.

4. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për hapjen e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit privat, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, për zhvillimin e pronës nëpërmjet instrumentit të sipërmarrjes.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negocimin me subjekte private, me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronave të transferuara në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të projektit të investimit.

6. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit, si dhe të sigurojë regjistrimin, në emër të Republikës së Shqipërisë/Bashkisë Durrës/Korporatës, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit, të pronës së re shtetërore, që do të krijohet në kuadër të projekteve të investimit.

7. Në funksion të zhvillimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

8. Vendimi nr. 485, datë 1.8.2023, i Këshillit të Ministrave, "Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si autoritet kontraktor për realizimin e projektit të zonës multifunksionale përreth kompleksit të stadiumit 'Niko Dovana' në Durrës, përfshirë stadiumin", shfuqizohet.

9. Ngarkohen Bashkia Durrës, Federata Shqiptare e Futbollit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**Shtojca nr. 1**

**Pronat që transferohen në pronësi të Korporatës**

| Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e pasurisë (m²) | Nga sip. | | Institucioni me pronësi |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Truall (m²) | Ndërtesë (m²) | |
| 8513 | 1/29 | 504.76 | 504.76 | 200.72 | Shtet |

**Shtojca nr. 2**

**Pronat me funksion publik për të cilat Korporata vepron si zhvillues**

| Zona kadastrale | Nr. pasurisë | Sip. e pasurisë (m²) | Nga sip. | | Institucioni me pronësi |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Truall (m²) | Ndërtesë (m²) | |
| 8513 | 1/27 | 19367.4 | 19367.4 | 0 | Bashkia Durrës |
| 8513 | 1/31 | 609.42 | 609.42 | 0 | Bashkia Durrës |
| 8513 | 1/33 | 2125.51 | 2125.51 | 0 | Bashkia Durrës |
| 8513 | 1/168 | 7518.84 | 7518.84 | 0 | Bashkia Durrës |
| 8513 | 1/162 | 2946.04 | 2946.04 | 0 | Bashkia Durrës |
| 8513 | 1/159 | 7105.83 | 7105.83 | 0 | Bashkia Durrës |
| 8513 | 1/34 | 1703.31 | 1703.31 | 0 | Bashkia Durrës |
| 8513 | 1/32 | 24827.4 | 24827.4 | 0 | Bashkia Durrës |
| 8513 | 1/100 | 503.49 | 0 | 0 | Shtet |
| 8513 | 1/101 | 2116.03 | 0 | 0 | Shtet |
| 8513 | 1/161 | 556.59 | 0 | 0 | Shtet |
| 8513 | 1/163 | 189.51 | 0 | 0 | Shtet |
| 8513 | 1/165 | 266.15 | 0 | 0 | Shtet |
| 8513 | 1/167 | 706.41 | 0 | 0 | Shtet |
| 8513 | 1/30 | 1601.18 | 0 | 0 | Shtet |
| 8513 | 1/28 | 834.16 | 0 | 0 | Shtet |
| 8513 | 1/121 | 1477.97 | 0 | 0 | Shtet |
| 8513 | 1/160 | 1201.75 | 0 | 0 | Shtet |

**Shtojca nr. 3**

**Institucionet publike, të cilat lidhin marrëveshjen e bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare**

Bashkia Durrës, Federata Shqiptare e Futbollit, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.

**VENDIM**
**Nr. 346, datë 19.6.2025**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 548, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, "Lista e institucioneve qendrore buxhetore", që i bashkëlidhet vendimit nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar, në ndarjen e tretë "Institucione në varësi të Kryeministrit", emërtesa "Inspektorati Qendror" zëvendësohet me "Inspektorati i Përgjithshëm".

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 347, datë 19.6.2025**

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE "REGJISTRI ELEKTRONIK I NËPUNËSVE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Krijimin, pranë institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, KDIMDHP), e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri elektronik i nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave personale" (në vijim, RENMDHP), përmbajtja e së cilës publikohet në faqen zyrtare të internetit të KDIMDHP-së.

II. KDIMDHP-ja është përgjegjëse për krijimin, mbajtjen, administrimin, ndërveprimin me bazat e tjera dhe bërjen të disponueshëm të informacionit, në përmbajtje të bazës së të dhënave "Regjistri elektronik i nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave personale".

III. RENMDHP-ja përmban të dhëna për nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave personale (në vijim, NMDHP), caktuar nga kontrolluesit dhe përpunuesit.

IV. Të dhënat që përmban RENMDHP-ja ndahen në të dhëna parësore dhe në të dhëna dytësore, si më poshtë:

1. Të dhëna parësore janë:

a) të dhënat mbi NMDHP-në;

b) adresa e postës elektronike;

c) adresa e ushtrimit të veprimtarisë;

ç) numri i kontaktit;

d) të dhënat mbi kontrolluesit/përpunuesit, ku është caktuar NMDHP-ja;

dh) trajnimet dhe certifikatat e NMDHP-së, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

2. Të dhëna dytësore janë ato të dhëna që merren nga ndërveprimi me bazat e të dhënave shtetërore, si më poshtë vijon:

a) Nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile merr të dhënat e mëposhtme:

i. emrin dhe mbiemrin e NMDHP-së;
ii. numrin personal të NMDHP-së;
b) Nga Regjistri Tregtar i QKB-së merr të dhënat e mëposhtme:
i. NIPT-in e kontrolluesit/përpunuesit;
ii. adresën e postës elektronike zyrtare të kontrolluesit/përpunuesit;
iii. adresën e kontrolluesit/përpunuesit;
iv. numrin e telefonit të kontrolluesit / përpunuesit;
c) Nga Regjistri Elektronik Kombëtar i Organizatave Jofitimprurëse merr të dhënat e mëposhtme:
i. të dhënat e identifikimit të organizatës jofitimprurëse;
ii. adresën e postës elektronike zyrtare të kontrolluesit/përpunuesit;
iii. adresën e kontrolluesit/përpunuesit;
iv. numrin e telefonit të kontrolluesit / përpunuesit.

V. Dhënësi i informacionit për RENMDHP-në është KDIMDHP-ja.

VI. Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të RENMDHP-së është, si më poshtë vijon:

1. Qytetarët (subjekte të të dhënave personale) kanë nivel aksesi si lexues dhe konsultues, lidhur me informacionin e vënë në dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të KDIMDHP-së;
2. NMDHP-të dhe kontrolluesit e përpunuesit publikë dhe privatë kanë të njëjtin nivel aksesi si ai i parashikuar në pikën 1 të kësaj ndarjeje.
3. KDIMDHP-ja ka akses si administrator dhe përdorues në RENMDHP. Niveli i aksesimit, funksionet dhe të drejtat për secilën kategori konsultuesish dhe përdoruesish të sistemit, si dhe për punonjësit e KDIMDHP-së janë në përputhje me pozicionin e punës dhe përcaktohen në rregulloren "Për sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore të krijuara në KDIMDHP", miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

VII. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të RENMDHP-së në KDIMDHP, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

VIII. "Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese" vijon të funksionojë si "Regjistri elektronik i nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave personale", në përputhje me këtë vendim, duke bërë ndryshimet përkatëse.

IX. Vendimi nr. 144, datë 13.3.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore 'Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese'", shfuqizohet.

X. Ngarkohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**VENDIM**
**Nr. 348, datë 19.6.2025**

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 61, DATË 3.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË PAJISJEVE MJEKËSORE TË RIMBURSUESHME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 9.2, të vendimit nr. 61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme", të ndryshuar, shtohet pika 9.3, me këtë përmbajtje:

"9.3 Paketat e trajtimit të stomës, që do të rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, janë sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për vitin 2025.

3. Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

SHTOJCA 2

**PAKETAT E TRAJTIMIT TË STOMËS TË RIMBURSUARA, QË TREGTOHEN NË FARMACITË E SPITALEVE**

| Paketa e trajtimi të kolostomës | Kosto në lekë | Marzhi i fitimit në përqindje | Çmimi i paketës | Prodhuesi |
|---|---|---|---|---|
| *Në këtë paketë përfshihen:* | 13,400 | 5.5% | 14,100 | Welland Medical Ltd, Hydehurst Lane, Crawley, Eest Sussex, RH 10, 9AS, United Kingdom |
| Sistem nje-pjesesh kolostomie pa shkarkim | | | | Vitaimed Instrument CO. LTD, No1, nanmatou Road Putong New district 200125, Shanghai, China |
| ose | | | | Lentismed d.o.o Slavonska avenija, 26/9, 10000 Zagreb, Croatia |
| Sistem dy-pjesesh, qese kolostomie pa shkarkim dhe Sistem dy-pjesesh, baza standarte | | | | Oxmed International GmbH, Groendeah Ischer Weg 87, 46446, Emmerich am Rhein, Germany |
| Spraj per heqjen e adezivit | | | | |
| Paste Barrier | | | | |
| | 14,500 | 5.50% | 15,300 | Wuhan Sitaili Medical Apparatus Development/China |

Rr. "Sami Frashëri", nr. 8, Tiranë. Tel: +3554223815. E-mail: info@fsdksh.gov.al. Web://www.fsdksh.gov.al 1-5

| Paketa e trajtimi të urostomës | Kosto në lekë | Marzhi i fitimit në përqindje | Çmimi i paketës | Prodhuesi |
|---|---|---|---|---|
| *Në këtë paketë përfshihen:* | 12,300 | 5.5% | 13,000 | Welland Medical Ltd, Hydehurst Lane, Crawley, Eest Sussex, RH 10, 9AS, United Kingdom |
| Sistem nje-pjesesh urostomie me shkarkim | | | | Vitaimed Instrument CO. LTD, No1, nanmatou Road Putong New district 200125, Shanghai, China |
| ose | | | | Lentismed d.o.o Slavonska avenija, 26/9, 10000 Zagreb, Croatia |
| Sistem dy-pjesesh, qese urostomie me shkarkim dhe Sistem dy-pjesesh, baza standarte | | | | Oxmed International GmbH, Groendeahlscher Weg 87, 46446, Emmerich am Rhein, Germany |
| Spraj per heqjen e adezivit | | | | |
| Paste Barrier | | | | |
| | 13,100 | 5.50% | 13,800 | Wuhan Sitaili Medical Apparatus Development/China |

Rr. "Sami Frashëri", nr. 8, Tiranë. Tel: +3554223815. E-mail: info@fsdksh.gov.al. Web://www.fsdksh.gov.al 1-7

| Paketa e trajtimi të ileostomës | Kosto në lekë | Marzhi i fitimit në përqindje | Çmimi i paketës | Prodhuesi |
|---|---|---|---|---|
| *Në këtë paketë përfshihen:* | 13,400 | 5.5% | 14,200 | Welland Medical Ltd, Hydehurst Lane, Crawley, Eest Sussex, RH 10, 9AS, United Kingdom |
| Sistem nje-pjesesh ileostomie me shkarkim | | | | Vitaimed Instrument CO. LTD, No1, nanmatou Road Putong New district 200125, Shanghai, China |
| ose | | | | Lentismed d.o.o Slavonska avenija, 26/9, 10000 Zagreb, Croatia |
| Sistem dy-pjesesh, qese ileostomie me shkarkim dhe Sistem dy-pjesesh, baza standarte<br>Spraj per heqjen e adezivit<br>Paste Barrier | | | | Oxmed International GmbH, Groendeahlscher Weg 87, 46446, Emmerich am Rhein, Germany |
| | 14,550 | 0 | 15,350 | Wuhan Sitaili Medical Apparatus Development/China |

**VENDIM**
**Nr. 28, datë 30.4.2025**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Holta Zaçaj | kryetare; |
| Marsida Xhaferllari | anëtare; |
| Fiona Papajorgji | anëtare; |
| Sonila Bejtja | anëtare; |
| Sandër Beci | anëtar; |
| Genti Ibrahimi | anëtar; |
| Marjana Semini | anëtare, |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 30.4.2025 mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 13 (T) 2024, që u përket:

KËRKUES: Tunxh Vatnikaj

SUBJEKT I INTERESUAR:

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR , përfaqësuar nga kryetari Ilir Rusi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 243, datë 29.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nr. 42, datë 28.2.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 00-2024-3030 (310), datë 11.7.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ);* ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Tunxh Vatnikaj *(kërkuesi),* i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor *(KLGJ),* që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 2526, datë 14.2.2000. Me kërkesën e tij, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 21.5.2008, kërkuesi është emëruar drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(AKKP),* bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 9877/2008).* Sipas kësaj dispozite, gjyqtarëve u lindte e drejta që me kërkesë të institucioneve dhe me pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë *(KLD)* të shërbenin për një afat deri në tre vjet në pozicione të tjera dhe në përfundim të këtij afati të ktheheshin në vendin e mëparshëm të punës.

2. Me vendimin nr. 54, datë 21.1.2009, të Këshillit të Ministrave kërkuesi është shkarkuar nga detyra e drejtorit të AKKP-së për shkelje disiplinore. Po kështu, për kërkuesin është regjistruar procedimi penal nr. 4908 i vitit 2008 për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve paraprake, në datën 24.4.2009 prokuroria ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit. Pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale ndaj kërkuesit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 718, datë 7.5.2012, ka vendosur deklarimin të pafajshëm të tij, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1280, datë 13.2.2013.

3. Pasi vendimi i pafajësisë së tij ka marrë formë të prerë, me kërkesën e datës 18.2.2013 kërkuesi i është drejtuar KLD-së për rikthimin në detyrën e gjyqtarit, kërkesë për të cilën ai nuk ka marrë përgjigje. Në këtë situatë, në datën 17.3.2015 ai i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt detyrimin e palës së paditur, KLD-së, që të marrë në shqyrtim kërkesën për rikthimin e tij në detyrën e gjyqtarit, si dhe detyrimin e atij organi për t'i paguar pagën e gjyqtarit nga data 21.2.2009 deri në fillimin e detyrës.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2839, datë 25.5.2015, ka

vendosur, ndër të tjera, pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, detyrimin e palës së paditur, KLD-së, që të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuesit të depozituar në datën 18.2.2013. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 121, datë 28.1.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1057, datë 16.10.2018, ka vendosur mospranimin e rekursit të KLD-së.

5. Për shkak se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, si më sipër, nuk është ekzekutuar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) me aplikimin nr. 42612/19, datë 8.8.2019, për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Me vendimin e datës 4.7.2024, GJEDNJ-ja ka vendosur nxjerrjen e këtij aplikimi nga lista, në përputhje me nenin 37, pika, 1, shkronja "c", të KEDNJ-së, për shkak të zgjidhjes së çështjes me marrëveshje, pasi shteti shqiptar ka pranuar t`i paguajë kërkuesit dëmshpërblim për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

6. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë KLGJ-së, organi që sipas nenit 147/a të Kushtetutës, pas ndryshimeve të vitit 2016, ka kompetencën për të vendosur për emërimin, vlerësimin, transferimin, masat disiplinore të gjyqtarëve të të gjitha niveleve etj. Me vendimin nr. 243, datë 29.10.2019 *(vendimi nr. 243/2019),* KLGJ-ja ka vendosur refuzimin e kësaj kërkese. Sipas saj, kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për t'u rikthyer në funksionin e tij në përfundim të afatit 3-vjeçar të komandimit, ndaj KLD-ja nuk mund të vijonte ruajtjen e vendit të punës si gjyqtar, pasi kërkuesi nuk ka kërkuar rikthimin me veprime konkludente; nuk i është nënshtruar rivlerësimit kalimtar e nuk ka plotësuar dhe dorëzuar formularët përkatës për këtë qëllim; nuk ka paraqitur kërkesë për pavlefshmëri të akteve të procedimit penal dhe nuk ka qenë i pezulluar nga detyra e gjyqtarit; nuk ka kundërshtuar aktin e shkarkimit nga detyra të drejtorit të AKKP-së; masa disiplinore e shkarkimit nga detyra përbën kriter ndalues për rekrutimin e gjyqtarit, si dhe është shkak për mbarimin e statusit të magjistratit.

7. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 115/2016, datë 3.11.2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" *(ligji nr. 115/2016),* me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit të KLGJ-së, detyrimin e kësaj të fundit ta kthejë në funksionin e gjyqtarit, si dhe rregullimin e pasojave për pagesën e pagës nga data 21.2.2009 deri në rikthimin e tij në funksionin e gjyqtarit.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 42, datë 28.2.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se mosparaqitja në kohë e kërkesës për rikthimin në detyrë është ekuivalente me dorëheqjen. Po kështu, sipas asaj gjykate, për sa kohë nuk është provuar dhënia e autorizimit nga KLD-ja për fillimin e procedimit penal, kërkuesi nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni i tij, prandaj, pavarësisht se me vendim të formës së prerë është deklaruar i pafajshëm, nuk kishte më të drejtë të kthehej në detyrën e mëparshme. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjatë kohës që rekursi ishte ende në shqyrtim kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë që kishte vendosur detyrimin e palës së paditur, KLD-së, që të merrte në shqyrtim kërkesën e kërkuesit. Në datën 12.2.2021, pasi kërkesa kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i atij ankimi kushtetues. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 31/b të ligjit nr. 8577/2000, me vendimin nr. 5, datë 16.2.2021, Gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

9. Për sa i përket shqyrtimit të rekursit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3030 (310), datë 11.7.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 28.2.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se ai vendim është i drejtë, ndërsa vendimi i KLGJ-së, me të cilin është refuzuar kërkesa e kërkuesit për kthimin e tij në funksionin e gjyqtarit, është një akt administrativ i mbështetur në prova dhe në ligj.

10. Në datën 9.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 16.10.2024. Me vendimin e datës 26.12.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për

shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

11. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në datën 1.4.2025, një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, e cila është pranuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 7, datë 3.4.2025. Në datën 2.4.2025 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e të njëjtit gjyqtar nga shqyrtimi i çështjes së tij, për të cilën Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 8, datë 3.4.2025, ka vendosur pushimin e shqyrtimit të saj, pasi kërkesa ka mbetur pa objekt.

## II
## Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

12.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

12.1.1. *Së drejtës së aksesit efektiv*, pasi gjatë procesit administrativ, as kërkuesi, as përfaqësuesi i tij nuk kanë pasur mundësi të paraqesin argumentet e tyre, ndërsa gjykatat nuk e kanë thirrur asnjëherë për të parashtruar pretendimet e tij. Po kështu, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit, ndonëse çështja e kërkuesit është gjykuar në shkallë të parë në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ka pasur juridiksion fillestar.

12.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi megjithëse Gjykata e Lartë ka pasqyruar faktin se kërkuesi është shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë, sërish ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke mos e rikthyer në detyrë atë. Pavarësisht se kërkesa për të përfituar të drejtat që njeh statusi i gjyqtarit është paraqitur nga kërkuesi menjëherë pas marrjes së vendimit të pafajësisë, KLD-ja nuk e ka marrë asnjëherë në shqyrtim atë. Gjykatat kanë arritur në përfundimin se statusi i gjyqtarit ka mbaruar "në heshtje", ndonëse ky term nuk gjendet në ligj dhe vendimet e tyre janë kontradiktore në lidhje me faktet dhe provat. Argumenti se nuk janë paraqitur dokumentet për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar nuk qëndron, pasi kërkuesi nuk ishte pjesë e listës së gjyqtarëve. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendimin e saj vendimin e GJEDNJ-së për çështjen e kërkuesit.

12.2. *Të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, pasi për shkak të vendimeve gjyqësore të cilat kanë lejuar shkelje të procesit të rregullt, kërkuesit i kanë ardhur pasoja për ushtrimin e profesionit të tij. Gjatë gjithë periudhës pas shkarkimit kërkuesi nuk ka ushtruar asnjë funksion tjetër, duke respektuar statusin e gjyqtarit.

**13. *Subjekti i interesuar, KLGJ-ja,*** ka prapësuar si vijon:

13.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit efektiv* është i pabazuar, pasi për sa i përket procesit administrativ të zhvilluar nga KLGJ-ja, referuar dispozitave ligjore administrative, e drejta e palës për t'u dëgjuar ushtrohet në çdo formë të përshtatshme, përfshirë rastin kur pala ka paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet në formë shkresore. Në procedurat administrative nuk kërkohet detyrimisht zhvillimi i një seance dëgjimore. Edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar brenda kompetencave të tij ligjore për sa i përket shqyrtimit të rekursit mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit, sipas nenit 61, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012).* Ky kolegj ka krijuar bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, për rrjedhojë është në kompetencën e tij të vendosë mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

13.2. Edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar. *Së pari,* për sa i përket pretendimit se Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendim procesin e zhvilluar në GJEDNJ, rezulton se kërkuesi ka pretenduar atje mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor për shkak të procedurave të gjata dhe mungesën e një mjeti efektiv. Pra, objekti i vendimit të GJEDNJ-së nuk është shfuqizimi i vendimit nr. 243/2019 të KLGJ-së, i lënë në fuqi nga gjykata e apelit. *Së dyti*, Gjykata e Lartë u ka kthyer përgjigje shteruese pretendimeve të parashtruara në rekurs dhe vendimi i saj është i qartë, logjik dhe nuk ka kundërthënie. Madje në rastin konkret nuk është ndryshuar vendimmarrja, por është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së apelit.

## III
## Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

*A. Për legjitimimin e kërkuesit*

14. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive kërkon që, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, kërkuesi duhet të vërtetojë se ka përdorur në formë dhe substancë të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura *(shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 38, datë 12.7.2023, të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës së aksesit efektiv si element i së drejtës për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, si për sa i përket procesit administrativ të zhvilluar në KLGJ, ashtu edhe procesit gjyqësor në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës së aksesit në procesin administrativ dhe procesin gjyqësor në gjykatën e apelit, Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, konstaton se këto pretendime nuk janë ngritur më parë nga kërkuesi, në formë dhe përmbajtje, as në kërkesëpadinë me të cilën ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor të kundërshtuar, as në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por janë parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se për këto pretendime kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuesi i ka ngritur ato më parë në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme, ndaj ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

18. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 11.7.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 9.10.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës së aksesit efektiv* në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe *standardit të arsyetimit të vendimit*, si dhe cenimin e *së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, të parashikuara në nenet 42 dhe 49 të Kushtetutës. Për sa i përket së drejtës së aksesit efektiv, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin e tij në dhomën e këshillimit, ndonëse kjo çështje është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit si gjykatë e shkallës së parë, e cila ka pasur juridiksion fillestar për këto lloj çështjesh. Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtij pretendimi, vlerëson ta analizojë atë në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

20. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë*

*2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese).* Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkuesit i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe mbrojtur *(shih vendimet nr. 27 datë 18.5.2023; nr. 28, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Gjykata vëren se referuar nenit 100 të ligjit nr. 115/2016, kërkuesi ka ankimuar aktin administrativ individual, vendimin nr. 243/2019 të KLGJ-së, në Gjykatën Administrative të Apelit. Në përfundim të atij gjykimi kërkuesi ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs dhe çështja e tij është shqyrtuar nga ajo gjykatë në dhomën e këshillimit. Për sa i përket rregullave të shqyrtimit të rekursit, neni 61, pika 1, i ligjit nr. 49/2012 ka parashikuar se shqyrtimi i tij në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe sipas nenit 62 të këtij ligji vetëm në raste të veçanta të parashikuara nga ligji, Gjykata e Lartë vendos kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

22. Për sa më sipër, Gjykata vëren se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë janë vënë në lëvizje nga kërkuesi përmes mjeteve të ankimit dhe rekursit, në përmbajtje të të cilave ai ka parashtruar të gjitha shkaqet kundër vendimit të KLGJ-së dhe vendimit të gjykatës së apelit. Kërkuesi është njoftuar rregullisht për gjykimin në gjykatën e apelit, ku ka qenë i pranishëm në seancat gjyqësore të zhvilluara, proces që është zhvilluar me praninë e palëve dhe ku kërkuesit i është garantuar e drejta të parashtrojë pretendimet e tij dhe të kundërshtojë ato të palës tjetër në proces. Për sa i përket gjykimit në Gjykatën e Lartë kërkuesi ka pasur të gjitha mundësitë të parashtrojë pretendimet e tij për vendimet e kundërshtuara dhe ajo gjykatë ka vepruar në përputhje me parashikimet procedurale që rregullojnë atë lloj gjykimi. Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezultojnë të pasqyruara të dhëna të plota për njoftimet për datën e seancës së planifikuar nga ajo gjykatë për shqyrtimin e rekursit.

23. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë në këndvështrimin kushtetues pasojat në të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur për shkak të mënyrës sesi është zhvilluar procesi gjyqësor i kundërshtuar, ndaj vetëm fakti që gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomën e këshillimit nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt, për më tepër në situatën që ajo gjykatë është vënë në lëvizje me rekursin e paraqitur nga kërkuesi, të cilin e ka marrë në shqyrtim, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të tij. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur është haptazi i pabazuar.

24. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së *drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme,* kërkuesi ka parashtruar se mënyra si gjykatat kanë vlerësuar dhe interpretuar ligjin për situatën e tij faktike ka sjellë pasoja në lidhje me ushtrimin e profesionit të tij dhe ai është detyruar të mos ushtrojë asnjë funksion tjetër, duke respektuar statusin e gjyqtarit.

25. Sipas nenit 49, pika 1, të Kushtetutës, secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që ka zgjedhur ose pranuar vetë dhe ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional. Në këtë drejtim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kjo e drejtë përfshin zgjedhjen e profesionit, vendit të punës, si dhe sistemit të kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit, në kuptimin që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi *(shih vendimet nr. 1 datë 25.1.2024; nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 9, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Në referim të këtij standardi, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka argumentuar se në çfarë mënyre refuzimi i KLGJ-së për ta rikthyer atë në detyrën e gjyqtarit përfshihet në fushën e veprimit të kësaj të drejte kushtetuese. Për rrjedhojë, për sa kohë që kërkuesi nuk ka arritur ta argumentojë këtë pretendim në aspektin kushtetues, ai nuk mund të merret në shqyrtim.

27. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* mbi argumentet se Gjykata e Lartë ka interpretuar në mënyrë kontradiktore faktet e provat dhe nuk ka marrë parasysh vendimin e pafajësisë së tij, duke bërë një interpretim të gabuar të kuadrit ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjykata, në kuptim të ndarjes së

juridiksionit të gjykatave të zakonshme nga ai kushtetues, ka theksuar se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim prej saj, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Në këtë kuptim, kjo Gjykatë vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, Gjykata do t'i analizojë në themel këto pretendime të kërkuesit në kuptim të së drejtës për gjykim të drejtë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

*B. Për themelin e pretendimeve*

*B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë*

28. Kërkuesi ka pretenduar se megjithëse Gjykata e Lartë ka pasqyruar faktin se ai është shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë, sërish ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke mos e rikthyer në detyrë. Sipas tij, pavarësisht se kërkesa për të përfituar të drejtat që njeh statusi i gjyqtarit është paraqitur nga kërkuesi menjëherë pas marrjes së vendimit të pafajësisë, KLD-ja nuk e ka marrë asnjëherë në shqyrtim atë. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat kanë arritur në përfundimin se statusi i gjyqtarit ka mbaruar "në heshtje", ndonëse ky term nuk gjendet në ligj dhe vendimet e tyre janë kontradiktore në lidhje me faktet dhe provat. Edhe argumenti se nuk janë paraqitur dokumentet për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar nuk qëndron, pasi kërkuesi nuk ishte pjesë e listës së gjyqtarëve. Gjithashtu, sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendimin e saj vendimin e GJEDNJ-së dhe nuk ka respektuar vendimet e Gjykatës, të cilat kanë fuqi detyruese.

29. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit është i pabazuar. Sipas këtij subjekti, për sa i përket argumentit se Gjykata e Lartë nuk ka pasqyruar në vendimin e saj procesin e zhvilluar nga kërkuesi në GJEDNJ, rezulton se ai ka të bëjë me mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor për shkak të procedurave të gjata dhe mungesën e një mjeti efektiv. Pra, objekti i vendimit të GJEDNJ-së nuk është shfuqizimi i aktit administrativ nr. 243/2019 të KLGJ-së i lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Po kështu, sipas subjektit të interesuar, Gjykata e Lartë u ka kthyer përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuesit të parashtruara në rekurs dhe vendimi i kundërshtuar është i qartë, logjik dhe nuk ka kundërthënie. Për më tepër në rastin konkret nuk është ndryshuar vendimmarrja, por është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së apelit.

30. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 67, datë 6.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Për sa më lart, Gjykata vëren se thelbi i çështjes në shqyrtim është mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë zbatuar kuadrin ligjor në fuqi që rregullon rastet e kthimit në funksionin e gjyqtarit, ndaj ajo do të verifikojë nëse gjykatat kanë zbatuar standardin e mësipërm dhe nëse interpretimi i ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete është apo jo haptazi i paarsyeshëm, në kuptimin që të ketë sjellë një përfundim arbitrar për kërkuesin në drejtim të garantimit të të drejtave që ai ka kërkuar të mbrojë përmes procesit gjyqësor të kundërshtuar.

32. Gjykata vëren se kërkuesi, gjatë kohës që ushtronte funksionin e gjyqtarit të zakonshëm, është lejuar me vendim të KLD-së të ushtrojë detyrën e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për një periudhë 3-vjeçare. Gjatë kësaj periudhe kërkuesi është akuzuar dhe është gjykuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës". Pas përfundimit të procesit penal dhe deklarimit të tij të pafajshëm me vendim të formës së prerë të gjykatës së apelit, kërkuesi ka kërkuar nga KLD-ja rikthimin në detyrë. Për shkak se nuk ka marrë përgjigje nga ai organ, kërkuesi ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor, përmes të cilit gjykatat kanë detyruar KLD-në që të shqyrtojë kërkesën e tij. Megjithatë edhe ky vendim ka mbetur i paekzekutuar dhe kërkesa e kërkuesit nuk është shqyrtuar asnjëherë nga KLD-ja (organi kompetent në atë kohë). Pas reformës kushtetuese të vitit 2016, e cila solli edhe ristrukturimin e disa organeve të sistemit të drejtësisë, kërkuesi i është drejtuar KLGJ-së me

kërkesë për rikthimin në funksionin e gjyqtarit, kërkesë e cila është refuzuar. Ky vendim është kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me kompetencën e saj, e cila ka rrëzuar padinë me arsyetimin se kërkesa për rikthimin në funksionin e gjyqtarit nuk është paraqitur brenda afatit 3-vjeçar sipas ligjit nr. 9877/2008 dhe se heshtja e kërkuesit përgjatë kësaj periudhe përbën, në thelb, heqje dorë nga e drejta. Sipas asaj gjykate, mosparaqitja në kohë e kërkesës për rikthim në detyrë është ekuivalente me dorëheqjen sipas pikës "a" të nenit 20 të ligjit nr. 9877/2008. Gjykata e apelit ka vlerësuar se për sa kohë nuk është provuar dhënia e autorizimit nga KLD-ja për fillimin e procedimit penal, kërkuesi nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni i tij, prandaj, pavarësisht se me vendim të formës së prerë është deklaruar i pafajshëm, nuk kishte më të drejtë të kthehej në detyrën e tij të mëparshme *(shih faqet 27–29 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit).*

33. Vendimi i gjykatës së apelit është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, me arsyetimin se kërkuesi ka humbur statusin e gjyqtarit, për shkak se ai nuk ka paraqitur kërkesë për rikthim as kur u shkarkua nga Këshilli i Ministrave si drejtor i AKKP-së, as në përfundim të afatit 3-vjeçar të komandimit, i cili ka përfunduar në vitin 2011. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk ka paraqitur as kërkesë për t'iu nënshtruar vullnetarisht procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 84/2016),* ndonëse mendonte se ishte në kushtet kur ai duhej të rikthehej në detyrë. Për më tepër, sipas asaj gjykate, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra si drejtor i AKKP-së përbënte, sipas nenit 28, shkronja "dh", të ligjit nr. 96/2016, ndalim për KLGJ-në që të rikthente kërkuesin në detyrën e gjyqtarit *(shih paragrafët 20, 21 dhe 23 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

34. Gjykata, bazuar në arsyetimin e gjykatave të zakonshme vëren se argumentet e tyre kryesore për rrëzimin e padisë kanë qenë: i. kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë në përfundim të afatit 3-vjeçar dhe nuk ka qenë i pezulluar nga funksioni i gjyqtarit, për rrjedhojë statusi i gjyqtarit ka mbaruar në heshtje; ii. ndaj tij ka një masë disiplinore të shkarkimit nga detyra; iii. ai nuk i është nënshtruar rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, ajo do të verifikojë mënyrën sesi ato gjykata kanë zbatuar dhe interpretuar ligjin e zbatueshëm për secilin shkak.

35. *Së pari,* për sa i përket argumentit se statusi i gjyqtarit ka mbaruar në heshtje, pasi kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për rikthimin në detyrën e gjyqtarit në përfundim të afatit 3-vjeçar sipas nenit 28 të ligjit nr. 9877/2008, në fuqi në kohën e përfundimit të periudhës së komandimit, Gjykata vëren se kjo dispozitë parashikonte të drejtën e gjyqtarëve që me kërkesë të institucioneve e me pëlqimin e tyre dhe me vendim të KLD-së të shërbenin për një afat deri në tre vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në institucione të tjera, dhe në përfundim të këtij afati të ktheheshin në vendin e mëparshëm të punës. Po kështu, neni 4, pika 6, i ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", sipas parashikimeve në fuqi në atë kohë, parashikonte se gjyqtarët/prokurorët që shërbenin në nivelet drejtuese a ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemëroheshin gjyqtarë/prokurorë pa konkurs. Referuar nenit 20, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 9877/2008, në fuqi në kohën kur kërkuesi ka paraqitur kërkesën në KLD për rikthimin në detyrë, gjyqtari nuk mund të lëvizej nga detyra përveç rasteve kur dënohej me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Në rastin kur ndaj një gjyqtari jepej autorizimi për fillimin e procedimit penal, ai pezullohej nga detyra derisa të merrej vendim gjyqësor i formës së prerë dhe në rastet kur fajësia nuk provohej me vendim të formës së prerë, gjyqtari kishte të drejtën të kthehej në punën e tij të mëparshme dhe të përfitonte pagën e plotë që nga koha e pezullimit (neni 29). Kurse sipas pikës 2 të nenit 32 të po këtij ligji, shkelje shumë të rënda konsideroheshin aktet dhe sjelljet që diskreditonin rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit që lidheshin me shkaqe që kryheshin gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor.

36. Bazuar në aktet e çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesi është emëruar drejtor i AKKP-së në datën 21.5.2008, ndërsa në datën 21.1.2009 ai është shkarkuar nga kjo detyrë dhe ndaj tij ka nisur procedimi penal. Në datën 13.2.2013 është dhënë vendimi i formës së prerë i pafajësisë së tij. Ndërsa në datën 18.2.2013 është paraqitur kërkesa në KLD për rikthim në detyrë, e cila nuk u shqyrtua asnjëherë nga ky organ. Vetëm pas ankimit të kërkuesit në GJEDNJ, kërkesa e tij u mor në

shqyrtim nga KLGJ-ja, e cila me vendimin e datës 29.10.2019 vendosi refuzimin e saj, duke e konsideruar se është paraqitur tej afatit 3-vjeçar të komandimit. Sipas KLGJ-së, ky afat ka filluar në datën e emërimit të tij si drejtor i përgjithshëm i AKKP-së (datë 21.5.2008) dhe ka përfunduar në datën 21.5.2011.

37. Gjykata vëren se ky qëndrim i KLGJ-së është gjetur i drejtë nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, por asnjë nga këto gjykata nuk kanë analizuar në aspektin e përmbajtjes së ligjit material të zbatueshëm (ligji i kohës), në kuptim të parashikimeve të nenit 29 të ligjit nr. 9877/2008 dhe të pretendimeve të kërkuesit në këtë drejtim, nëse paraqitja e një kërkese të tillë, në kushtet kur kërkuesi gjatë periudhës së komandimit është marrë në cilësinë e të pandehurit dhe në vijim është gjykuar për kryerjen e veprave penale, do të kishte perspektivë suksesi dhe do të rezultonte një mjet efektiv që do të mundësonte kthimin e tij në detyrë brenda kohës së komandimit. Edhe për sa i përket argumentit të përdorur në vendimet objekt kundërshtimi se ndaj kërkuesit nuk është vendosur masa e pezullimit nga detyra e gjyqtarit, Gjykata çmon se gjykatat nuk kanë arsyetuar sesi neni 29 i ligjit nr. 9877/2008, që përcakton pezullimin nga detyra të gjyqtarit në rastin e ndjekjes penale ndaj tij, përbënte ose jo pengesë për kërkuesin (i cili ishte në ndjekje penale), për të paraqitur kërkesë për rikthimin në detyrë, ndërkohë kur KLD-ja as nuk e kishte pezulluar atë nga pikëpamja formale juridike me një vendim, as nuk e rikthente në detyrë, situata këto që duket se përjashtojnë njëra-tjetrën.

38. Nga ana tjetër, edhe pse kanë vlerësuar se statusi i gjyqtarit ka mbaruar në heshtje për kërkuesin, gjykatat e zakonshme nuk kanë analizuar faktet që kanë rezultuar gjatë gjykimit, të cilat janë përcaktuese të sjelljes së kërkuesit në drejtim të shprehjes së vullnetit për vijimin ose përfundimin e statusit të tij si gjyqtar dhe pasojat që vijnë nga veprimet e tij. Ndërkohë që rezulton se kërkuesi ka paraqitur kërkesë për kthim në detyrë përpara KLD-së vetëm 5 ditë pas vendimit të formës së prerë të gjykatës së apelit që e ka deklaruar atë të pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohej, bazuar në interpretimin që ai i ka bërë përmbajtjes së nenit 29 të ligjit nr. 9877/2008 në rastin e tij. Gjykata evidenton se gjykatat nuk kanë analizuar dhe as pasqyruar se kërkuesi në mënyrë të vazhdueshme ka shfaqur interes, në përputhje me interpretimin që ai u ka bërë dispozitave ligjore të zbatueshme dhe se ai ka përdorur çdo mjet që në dukje mund të rezultonte i suksesshëm për mbrojtjen e të drejtave të tij, siç ishte edhe kërkesa në GJEDNJ për konstatimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë që kishte vendosur detyrimin e KLD-së për t'u shprehur për kërkesën e tij për kthimin në funksionin e gjyqtarit. Ndonëse ky vendim nuk shprehet për themelin e çështjes së kërkuesit dhe ai ka marrë shpërblim të drejtë për shkeljen e konstatuar, një fakt i tillë nuk mund të shmangej nga Gjykata e Lartë, për sa kohë ai është tregues i sjelljes së kërkuesit në drejtim të kërkimit kryesor të padisë së tij, që është kthimi në funksionin e gjyqtarit dhe provon faktin se kërkuesi nuk ka pranuar në heshtje mbarimin e statusit të gjyqtarit.

39. Nga ana tjetër, gjykatat e zakonshme nuk kanë analizuar dhe nuk janë shprehur për sjelljen e organeve kompetente, konkretisht të KLD-së së kohës, e cila nuk e ka marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuesit për një periudhë disavjeçare (kërkesa është paraqitur më 18.2.2013 dhe deri më 12.12.2018, kur ka pushuar funksionet ky institucion, nuk është shqyrtuar), ndonëse prej saj nuk ka pasur më parë një vendim për pezullimin e kërkuesit nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit. Gjykata evidenton faktin se edhe pse kërkuesi ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor për detyrimin e KLD-së për të marrë në shqyrtim kërkesën e tij, padi që është pranuar, sërish KLD-ja nuk ka vepruar për të përmbushur detyrimin e saj për t'i dhënë përgjigje kërkuesit.

40. *Së dyti*, për argumentin se ndaj kërkuesit ka një masë disiplinore të shkarkimit nga detyra, Gjykata evidenton se neni 20 i ligjit nr. 9877/2008 parashikonte si shkak për mbarimin e statusit të gjyqtarit, ndër të tjera, shkarkimin nga detyra, ndërsa kjo masë, referuar nenit 32, pika 2, të këtij ligji, jepej për shkaqe që lidheshin drejtpërdrejt me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se masa e shkarkimit nga detyra është marrë gjatë ushtrimit të një funksioni administrativ, atij të drejtorit të AKKP-së, ndërsa gjykatat nuk kanë arsyetuar nëse një masë e tillë parashikohej edhe në ligjin e posaçëm, përkatësisht në nenin 32, pika 2, të ligjit nr. 9877/2008.

41. *Së treti*, për sa i përket argumentit të gjykatave se kërkuesi nuk i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, Gjykata vëren se sipas nenit 179/b të Kushtetutës (i shtuar me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016), procesit të rivlerësimit u

nënshtrohen edhe të gjithë gjyqtarët të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. Sipas parashikimeve kushtetuese, nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit (neni D, pika 5, i Kushtetutës) ose deklaratën për figurën në kohë (neni DH, pika 4, i Kushtetutës), ai shkarkohet nga detyra. Procesi i rivlerësimit është detajuar më tej në parashikimet e ligjit nr. 84/2016.

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme, mbi vlerësimin se kërkuesi nuk gëzonte statusin e gjyqtarit pas periudhës së komandimit, kanë pohuar se ai nuk ka depozituar as formularin e deklarimit të pasurisë pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që është një shkak tjetër që sjell pamundësinë e tij për t'u rikthyer në detyrë. Kjo do të thotë se gjykatat nuk kanë analizuar dhe interpretuar në mënyrë të plotë mënyrën e zbatimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për rivlerësimin kalimtar në atë kohë, pra në momentin e hyrjes në fuqi të tyre, përfshirë detyrimin e gjyqtarëve në detyrë ose të ish-gjyqtarëve për të dorëzuar formularët e vetëdeklarimit, në kushtet kur kërkuesi nuk kishte asnjë vendim të organit administrativ për statusin e tij, edhe pse ai vetë kishte kërkuar prej tyre të shpreheshin në këtë drejtim. Thënë ndryshe, gjykatat nuk kanë marrë në analizë efektet që do të kishte në rastin e kërkuesit një kërkesë drejtuar institucioneve të rivlerësimit paraprak sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore që normonin procesin e rivlerësimit, në mungesë të vendimit të organit kompetent (KLD/KLGJ) në atë kohë në lidhje me (mos)pasjen e statusit të gjyqtarit dhe në situatën që vetë kërkuesi, bazuar në qasjen e tij, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë statusin e gjyqtarit dhe vetë sistemin e rivlerësimit kalimtar. Për më tepër, sikurse rezulton nga rrethanat konkrete dhe faktet me natyrë kushtetuese të konstatuara gjatë këtij gjykimi, mosveprimi i kërkuesit edhe për paraqitjen e një kërkese të tillë është diktuar në radhë të parë nga mosveprimi i institucioneve kompetente për të përcaktuar statusin e tij.

43. Për sa më lart, Gjykata vë në dukje se Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes së kërkuesit, duke bërë një interpretim abstrakt të ligjit, i cili nuk pajtohet me gjykimin konkret, duke mos zgjidhur mosmarrëveshjen në fjalë. Në këtë kuptim, pjesa arsyetuese e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë rezulton të jetë formaliste, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së drejtës kushtetuese të individit. Për rrjedhojë, interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, në rastin në fjalë, i mungon analiza nga pikëpamja e faktit dhe e së drejtës, duke e bërë atë haptazi të paarsyeshëm.

44. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3030 (310), datë 11.7.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 30.4.2025.**
**Shpallur më 17.6.2025.**

**Kryetare:** Holta Zaçaj
**Anëtarë:** Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/06/23 16:24:57 +02'00'
b8f2f3e092494e5aa729b700d7db9eda2025062316245001031

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*